




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-1247/15 Prot. No.
Nr. I faq. Broj stranica 02 Nr. pages	Data Datum 29.04.2015 Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.04.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-510-15 për znj. Vlora Dumoshi – Këshilltare Komunale në Kuvendin e Prishtinës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë situatën konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur me kërkesën e palëve denoncuese nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-510-15, për Zyrтарen e lartë, znj. Vlora Dumoshi – Këshilltare Komunale në Kuvendin e Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj. Dumoshi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ajo është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast, është njoftuar me pretendimet nga pala e tretë për situatë të dyshuar për konfliktit interesit, duke qenë se znj. Dumoshi në cilësinë e Këshilltares Komunale në KK të Prishtinës në Seancën e jashtëzakonshme të datës 14 janar 2015 dhe në Seancën e rregulltë të Kuvendit të datës 05 shkurt 2015, gjatë procesit të diskutimeve dhe votimit, pretendohet se ka pasur Konflikt interesi me Vendimet e marra në KK të Prishtinës.

Në takim me znj. Dumoshi, dhe në bazë të Ekstraktit të Procesverbalit nga Mbledhja e Kuvendit të Prishtinës, mbajtur me 05.02.2015 (DPK/DPKI-03-02-815/15) kemi vërtetuar se në atë Seancë së pari me Vendim që ka dal nga votimi në Kuvend, janë shkarkuar Anëtarët e Komisioneve të Aksionarëve. Ndërsa, pastaj po ashtu pas votimit, është miratuar Vendimi për caktimin e Anëtarëve të Komisioneve të Aksionareve të Ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Nuk qëndron pretendimi se gjatë kohës së diskutimit në Seancat e Kuvendit Komunal të Prishtinës lidhur me shkarkimin e Anëtarëve të Komisioneve Komunale të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike, motra e Vlora Dumoshi-Albiona Dumoshi ka qenë Anëtare e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Komunale "Trafiku Urban" sh.a.

Znj.Albiona Dumoshi është shkarkuar nga kjo pozitë më 05.01.2015 (DPKI-DPKI-03-02-1227/15) dhe pikërisht si rezultat i këtij shkarkimi, ashtu siç e obligon ligji, me datën 06.02.20015 ajo ka bërë Deklarimin e Pasurisë pas largimit nga funksioni (DLF05434/2015/1).

Prandaj votimi i znj. Vlora Dumoshi në procesin e zgjedhjes së Anëtarëve të Komisionit të Aksionarëve nuk ka shkaktuar situatë me konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni /